



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 130 dt. 11.12.2014

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.12.2014, pasi shqyrtoi problematikat që kanë dalë gjatë punimeve për rehabilitimin e Sheshit “Beslidhja”, në qytetin e Lezhës, pranë Vend Varrimit të Skënderbeut, projekte të Bashkisë Lezhë (të miratuara nga KKR me Vendim nr.59 dt. 15.09.2014),

VENDOSI:

1. Bashkia të vendosë një rrethim të ulët prej hekuri, pasi mungesa e rrethimit me kangjella përbën rrezik për monumentin nga lëvizjet e pakontrolluara të vizitorëve si dhe kalimtarëve të rastit.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO TUBANI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI